



KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABDEVANJE D.D.
PRISHTINA

Nr. 550 / 02 APR 2019

Ekstrakt nga procesverbali i mbledhjes së Bordit të Drejtorëve të KRU
"PRISHTINA" SH.A të mbajtur me: 02.04.2019 mbledhja e IV-të e rregullt e vitit 2019.

Bordi i Drejtorëve i KRU "PRISHTINA" SH.A. duke u nisur nga Kërkesa nga Komuna e Prishtinës datë 23.01.2018 & 07.11.2017 dhe të mbështetura nga MZHE për parcelat për nevoja të Komunës Prishtinë-Drejtoria e Arsimit për prona për ndërtim të një objekti parashkollor në Lokacionin Fusha e Pajtimit me nr.Parcellave 831-1, 832-2, 834-1 me sipërfaqe 2961m². BD i ka trajtuar kërkesat dhe pasi që ka marr edhe mendimin e Kryeshefit Ekzekutiv, pas analizave dhe duke u bazuar në Ligjin NR.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare merr këtë:

V e n d i m 2019/04-04

- Jep pëlqimin Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik që të vendos në emër të Aksionarit, Qeveris së Republikës së Kosovës, për transferim të parcelës për interes të Publikut sipas kërkesës së Komunës Prishtinë-Drejtoria e Arsimit (pronë e pa luajtshme) sipas nr.te parcelave me nr.831-1, 831-2, 834-1 tek fusha e pajtimit zona kadastrale Prishtinë.

Arsyetimi:

Bordi i Drejtorëve pasi i analizoi kërkesat e Komunës së Prishtinës-Drejtoria e Arsimit për ndërtim të një objekti parashkollor, kërkesat me datë 23.01.2018 nr.89 & 07.11.2017-13-353/01.

Bordi i Drejtorëve duke u nisur nga këto kërkesa të mbështetura nga MZHE, pasi që morri edhe mendimin e Kryeshefit Ekzekutiv të KRUP për parcelat në fjalë që Kompania nuk ka ndonjë planë në kohën e tanishëm për ndonjë shfrytëzim të atyre parcelave.

Andaj Bordi i Drejtorëve duke i vlersuar rrethanat por edhe Ligjet në fuqi siç janë Ligji NR.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, si dhe Ligji 03/L-087 mbi Ndërmarrjet Publike, si dhe plotësim ndryshimet e Ligjit NR.04/L-111 & Ligj Nr.05/L-009. Duke u mbështetur në Ligjet në fuqi Bordi i Drejtorëve jep pëlqimin që MZHE të vendos për transferin e atyre parcelave në emër të Aksionarit që është Qeveria e Republikës së Kosovës.

Andaj BD me shumicë votash ka vendos si në piken e parë të ketijë dispozitivi.
Prishtinë, 02.04.2019

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve:

Amin Gashi, Jur. i Dipl.